



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS

QENDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

Kriteret dhe dokumentacioni i duhur, për aplikuesit që vijnë nga shtresat social-ekonomike në nevojë, të cilat i janë referuar kategorive vulnerabël sipas VKB-së Nr.40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”,

I. Dokumentacioni i duhur për secilën nga kategoritë.

- **Fëmijë me statusin e jetimit:**
 - Libreza e statusit të jetimit të fëmijës.
 - Certifikata personale e fëmijës dhe familjare.
- **Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit:**
 - Libreza e statusit të kujdestarit ligjor të fëmijës.
 - Certifikata personale e fëmijës dhe familjare.
- **Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor:**
 - Raporti mjeko-ligjor i fëmijës.
 - Certifikata personale dhe familjare e fëmijës.
- **Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike dhe me sëmundje të rënda, sipas raportit të komisionit mjeko-ligjor:**
 - Raporti mjeko-ligjor i kujdestarit ligjor të fëmijës.
 - Certifikata personale dhe familjare e fëmijës.
- **Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike:**
 - Certifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike të kujdestarit ligjor.
- **Fëmijët e familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës:**
 - Certifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë (24 000 lek).
 - Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin E-Sig 025/a, të kujdestarit ligjor.

- **Fëmijët e familjeve, ku kujdestari ligjor i fëmijës, është i divorcuar ose i ve, (sipas certifikatës së gjendjes familjare), por që është në/nën pagën minimale në shkallë, vërtetuar me dokumentacionin përkatës:**
 - Certifikata personale dhe familjare e fëmijës.
 - Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë (24 000 lek).
 - Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin E-Sig 025/a, të kujdestarit ligjor.

Dokumentacioni për kategoritë e tjera social-ekonomike:

- Certifikatë personale dhe familjare e fëmijës.
- Vërtetim pune me pagë mujore të pasqyruar, të kujdestarit ligjor (të prindërve).
- Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin E-Sig 025/a, të kujdestarit ligjor.

Shënim:

Të nderuar prindër dhe të afërm të fëmijëve!

Dokumentacionin e kërkuar si më sipër, mund ta shkarkoni nga sistemi elektronik **e-albania** si posedues të kodit personal me kartë indentiteti.

Në rastin kur kjo nuk është e mundur, duhet të dorëzoni pranë komisionit një fotokopje të kartës tuaj të indentitetit, si dhe të plotësoni deklaratën personale në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Për arsye se numri i aplikuesve, nisur edhe nga përvoja e viteve të mëparshme i kalon mbi 7000 aplikime, kjo e vështirëson shumë menaxhimin dhe më pas shqyrtimin korrekt të dokumentacionit në gjithë procesin.

Faleminderit për mirëkuptimin Tuaj!